



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



**Strategjia Komunale për Personat me Aftësi të  
Kufizuar në Komunën e Ferizajt dhe  
Plani i veprimit**

*2019 -2023*

## **Shkurtesat**

ATRC	Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim
DKA	Drejtoria Komunale e Arsimit
DKF	Drejtoria Komunale e Financave
DI	Drejtoria e Infrastrukturës
DUM	Drejtoria për Urbanizëm dhe Mjedis
DSHMS	Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Soziale
DPKGJ	Drejtoria Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë
DZHEK	Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm
DSHPE	Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës
DKRS	Departamenti për Kulturë, Rini dhe Sport
OPAK	Organizatat e Personave me Aftësi të Kufizuara
INPO	Iniciativa për Progres
PAK	Personat me Aftësi të Kufizuara
QPS	Qendra për Punë Sociale
QRP	Qendra Rajonale e Punësimit
QAP	Qendra për Aftësim Profesional
QKMF	Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare
PDK	Partia Demokratike e Kosovës
LDK	Lidhja Demokratike e Kosovës
AAK	Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës
LVV	Lëvizja Vetëvendosje
AKR	Aleanca Kosova e Re

Kuvendi Komunal i Ferizajt prezanton Strategjinë Komunale për Personat me Aftësi të Kufizuara dhe Planin e Veprimit. Përmes këtij dokumenti Kuvendi Komunal i Ferizajt synon të përmirësoj cilësinë e jetës së personave me aftësi të kufizuara, të promovoj një shoqëri gjithpërfshirëse si dhe të respektoj të drejtat e personave me aftësi të kufizuara si qytetarë me të drejta të barabarta në Komunën e Ferizajt.

### **Rëndësia e strategjisë komunale të Ferizajt për personat me aftësi të kufizuara**

Strategjia komunale për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në Komunën e Ferizajt ka për qëllim të jap një kornizë të veprimeve dhe aktiviteteve të Komunës së Ferizajt, përmes të cilave synon të përmirësoj cilësinë e jetës së personave me aftësi të kufizuara duke trajtuar sfidat dhe pengesat me të cilat përballen personat me aftësi të kufizuara.

Strategjia komunale për personat me aftësi të kufizuara do të përcaktoj vizionin dhe misionin e Komunës së Ferizajt si dhe veprimet konkrete të cilat do të ndërmirren me qëllim të përmirësimit të situatës së personave me aftësi të kufizuara në këtë komunë.

Ky dokument strategjik është një mjet i rëndësishëm në përpjekjet e institucioneve komunale për të krijuar një politikë më efektive, të qëndrueshme dhe të koordinuar në fushën e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara dhe mundëson veprime më të fokusuar në realizimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara dhe intensifikimin e përpjekjeve të gjithanshme të institucioneve drejt respektimit të plotë të këtyre të drejtave.

Kjo strategji do të jetë e rëndësishme për Komunën e Ferizajt për të siguruar që të gjitha parimet e Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, si dhe ligjet dhe politikat e Republikës së Kosovës janë inkuorporuar në aktivitetet dhe veprimet përmes të cilave do të respektohen të drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.

### **Përmbledhje Ekzekutive**

Që nga maji i vitit 2018, Handikos Ferizaj në kuadër të projektit „Qeverisje përfshirëse për personat me aftësi të kufizuara” i përkrahur nga Qendra për Avokim ATRC dhe financuar nga USAID, ka zhvilluar fokus grupet me qëllim të identifikimit të sfidave dhe pengesave me të cilat përballen personat me aftësi të kufizuara në Komunën e Ferizajt.

Gjatë punës me fokus grupe të personave me aftësi të kufizuara fizike, personave të verbër dhe me dëmtime në të parë, personave të shurdhër dhe me dëmtime në dëgjim si dhe anëtarët e familjeve të personave me aftësi të kufizuara janë identifikuar sfidat, pengesat dhe nevojat e shumta në fushën e mirëqenies, shëndetësisë, arsimit, punësimit, kulturës etj.

Strategjia komunale për personat me aftësi të kufizuara është rezultat i përpjekjeve të përbashkëta të Kuvendit Komunal të Ferizajt dhe organizatave të personave me aftësi të kufizuara në Komunën e Ferizajt për të ngritur cilësinë e jetës dhe përmirësuar situatën e personave me aftësi të kufizuara në fushat e identifikuara.

Me anë të strategjisë komunale për personat me aftësi të kufizuara Komuna e Ferizajt synon të përmirësoj gjendjen aktuale në këto fusha: Arsim dhe ngritje profesionale e mësimdhënësve për arsim gjithëpërfshirës; Shëndetësi dhe mirëqenie sociale; Aftësim profesional dhe punësim; si dhe Qasje. Për këtë qëllim janë përcaktuar objektivat strategjike për të cilat janë paraparë edhe veprime konkrete, afatet kohore si dhe linjat buxhetore.

Veç tjerash strategjia do të jetë udhërrëfyes për Komunën e Ferizajt për të punuar drejt respektimit të të drejtave të personave me aftësi të kufizuara duke siguruar zbatimin e legjislacionit nacional për personat me aftësi të kufizuara, si dhe gjithëpërfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në të gjitha sferat e shoqërisë. Ky dokument gjithashtu do të ndikoj në zvogëlimin e diskriminimit të qytetarëve në bazë të aftësisë së kufizuar si dhe fokusimin e shpenzimeve në fusha të rëndësishme të lartë duke klasifikuar prioritetet.

Pjesëmarrës në procesin e hartimit të strategjisë ishin Drejtorë të Departamenteve Komunale, Zyrtarë Komunal, Asambleistë si dhe përfaqësues të Organizatave të Personave me Aftësi të Kufizuara.

Strategjia Komunale për Personat me Aftësi të Kufizuara në Komunën e Ferizajt është e shtrirë për një periudhë pesë (5) vjeçare për zbatim dhe si e tillë synon arritjen e ngritjes së cilësisë për personat me aftësi të kufizuara në fushën e arsimit dhe ngritjes profesionale të mësimdhënësve, shëndetësisë, mirëqenies sociale, aftësimin profesional, punësimit dhe qasjes.

## Hyrje

Të drejtat dhe liritë themelore të personave me aftësi të kufizuara ende nuk janë të realizuara në nivel vendi dhe rrjedhimisht edhe në Komunën e Ferizajt. Ndaj, Komuna e Ferizajt në kuadër të përgjegjësisë dhe me qëllim të garantimit të të drejtave për personat me aftësi të kufizuara, synon të zvogëloj sfidat dhe barrierat të cilat krijojnë vështirësi në respektimin e të drejtave dhe liritë themelore të personave me aftësi të kufizuara.

Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë 15 përqind e popullatës botërore janë persona me aftësi të kufizuara. Në Kosovë akoma nuk ka shifra të sakta rreth këtij numri të komunikuar zyrtarisht nga institucionet publike dhe ky numër bazohet në përfituesit e skemave sociale dhe penzionet e aftësisë së kufizuar. Në Komunën e Ferizajt, ndonëse nuk ka ende të dhëna të sakta mendohet se rreth 1.800 persona i përkasin kësaj kategorie (duke marrë parasysh të gjitha llojet e aftësisë së kufizuar – fizike, intelektuale, në dëgjim, në të parë dhe të kombinuar). Megjithatë dihet se personat me aftësi të kufizuara vazhdojnë të jenë të marginalizuar dhe të hasin në vështirësi të cilat shpesh mund të cilësohen edhe si diskriminuese sa i përket gjithpërfshirjes së tyre por edhe qasjes së tyre në shërbime.

Në anën tjetër, shërbimet sociale në komunitet për personat me aftësi të kufizuara në nivel komunal janë të kufizuara, ndërsa shërbimet sociale të ofruara nga OJQ-të kanë mbetur kryesisht nën mbështetjen e agjencive dhe donatorëve të huaj, ndërkohë që mbështetja shtetërore nuk është e strukturuar, nuk është e qëndrueshme dhe në të njëjtën kohë mbetet shumë e kufizuar dhe pa një qasje afatgjatë. Madje sipas agjencionit të statistikave në Kosovë vetëm 10% e fëmijëve me aftësi të kufizuara përfitojnë nga shërbimet shëndetësore, arsimore dhe sociale. *(Të dhënat: Agjencioni i Statistikave të Kosovës)*. Mungesa e shërbimeve adekuate dhe të përshtatshme në nivel lokal, bën që shumë persona me aftësi të kufizuar dhe familjet e tyre të ndihen të pafuqishme në mbështetjen e zhvillimit psikosocial, rehabilitimin fizik në shtëpi dhe përfshirjen e tyre në arsimim dhe në jetën në komunitet.

Veç tjerash, mungesa e një baze të të dhënave lidhur me numrin e personave me aftësi të kufizuara dhe mungesa e informatave mbi nevojat e tyre në nivel të Komunës së Ferizajt, është paraqitur si problem për të zhvilluar politika lokale të mirëfillta për personat me aftësi të kufizuara dhe njëherit kufizon planifikimin e përgjegjshëm dhe zhvillimin e programeve mbështetëse për ndërhyrje. Ndonëse ka pasur përpjekje për t'i grumbulluar të dhënat nga OPAK-ët lokale, procesi i mbledhjes së të dhënave ka ngecur si rezultat i të dhënave të pa përditësuara. Lidhur me këtë çështje, Handikos Ferizaj në bashkëpunim me Qendrën për Punë Sociale ka përfunduar përditësimin dhe grumbullimin e të dhënave për numrin e saktë të PAK në Ferizaj i cili ka rezultuar me të dhëna të sakta për 944 persona me aftësi të kufizuar.

Baza e të dhënave pas përfundimit i është dorëzuar Komunës së Ferizajt si përgjegjëse për përditësimin e vazhdueshëm të saj.

Po ashtu nga hulumtimet e dala nga organizatat e personave me aftësi të kufizuara në Komunën e Ferizajt është identifikuar se ekzistojnë sfida të shumta në aftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara.

### **Metodologjia**

Procesi i zhvillimit të Strategjisë Komonale për Personat me Aftësi të Kufizuara në Komunën e Ferizajt u inicua nga Handikos Ferizaj në kuadër të projektit „Qeverisje përfshirëse për personat me aftësi të kufizuara” i përkrahur nga Qendra për Avokim ATRC dhe financuar nga USAID.

Puna rreth mbledhjes së të dhënave, sfidave dhe nevojave të personave me aftësi të kufizuara në komunën e Ferizajt ka filluar në qershor të vitit 2018 përmes takimeve me drejtoritë komunale, sesioneve informuese me asambleistë dhe fokus grupeve me personat me aftësi të kufizuara si dhe familjarëve të tyre. Po ashtu janë konsultuar edhe dokumentet e strategjive nacionale dhe legjislacioni nacional për personat me aftësi të kufizuara me të cilat duhej të ndërli dhe strategjia komunale për personat me aftësi të kufizuara në Komunën e Ferizajt.

Më 19-21 tetor 2018 u mbajt punëtorja tre-ditore për hartimin e strategjisë komunale për personat me aftësi të kufizuara në Komunën e Ferizajt. Pjesëmarrës në këtë punëtori ishin asambleistët e Kuvendit Komunal të Ferizajt, Drejtorët e Drejtorive Komunale në Ferizaj, Zyrtarët e Drejtorive të ndryshme nga Komuna e Ferizajt si dhe përfaqësues të OPAK dhe shoqërisë civile në Ferizaj.

Si rezultat i punëtorisë tre-ditore pjesëmarrësit kanë dalur me draftin e parë të strategjisë komunale për personat me aftësi të kufizuara dhe planin e veprimit.

### **Vizioni dhe misioni ynë**

Strategjia Komonale për Personat me Aftësi të Kufizuara në Komunën e Ferizajt 2019-2023 merr si pikënisje legjislacionin e miratuar nga Qeveria e Kosovës si dhe Strategjinë Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara në Republikën e Kosovës 2013-2023 dhe njëherit sfidat dhe problemet me të cilat përballen personat me aftësi të kufizuara në Komunën e Ferizajt të identifikuar gjatë punës me fokus grupe. Duke marrë parasysh gjendjen aktuale të personave me aftësi të kufizuara, dokumentet e sipërpërmendura si dhe nevojën për të përmirësuar gjendjen aktuale, palët e përfshira në zhvillimin e strategjisë

komunale për personat me aftësi të kufizuara në Komunën e Ferizajt kanë formuluar vizionin për këtë strategji: *Shoqëri gjithëpërfshirëse me mundësi të barabarta në të cilën personat me aftësi të kufizuara realizojnë dinjitetshëm potencialin e tyre të plotë.*

Deklarata e misionit e formuluar nga palët e përfshira në zhvillimin e strategjisë komunale për personat me aftësi të kufizuara në Komunën e Ferizajt tregon angazhimin e komunës për përmirësimin e gjendjes së personave me aftësi të kufizuara dhe nxit bashkëpunimin me komunitetin, OPAK-ët dhe OSHC-të tjera në Komunën e Ferizajt: *Komuna e Ferizajt në bashkëpunim me komunitetin do të angazhohet për përmirësimin e cilësisë së jetës së personave me aftësi të kufizuara.*

### **Objektivat strategjike**

Strategjia Komunale për Personat me Aftësi të Kufizuara 2019-2023 do të përcaktoj veprimet dhe aktivitetet e institucioneve komunale, por edhe OPAK-ve, OSHC-ve dhe donatorëve për personat me aftësi të kufizuara për pesë vite. Objektivat strategjike kanë për qëllim të transmetojnë synimet e Komunës së Ferizajt në realizimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara dhe pjesëmarrjes së tyre të plotë në shoqëri.

Objektivat strategjike janë formuluar duke marrë parasysh sfidat dhe problemet ekzistuese me të cilat përballen personat me aftësi të kufizuara në Komunën e Ferizajt, por dhe vështirësitë me të cilat përballen Komuna e Ferizajt, përfshirë mungesën e bazës së dhënave, mungesën e shërbimeve sociale, përmirësimin e cilësisë në arsim për fëmijët me aftësi të kufizuara, mungesën e mekanizmave për zbatimin e legjislacionit për punësim dhe aftësim të personave me aftësi të kufizuara, sigurimin e qasjes në jetën sociale, politike dhe ekonomike të personave me aftësi të kufizuara, përmirësimin e situatës jetësore dhe përmbushjen e nevojave të tyre.

Objektivat strategjike të Strategjisë Komunale për Personat me Aftësi të Kufizuara 2019-2023 përfshijnë aspektet kryesore të personave me aftësi të kufizuara me fokus të veçantë në fushat në vijim: Arsim dhe ngritje profesionale e mësimdhënësve; Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale; Aftësim Profesional dhe Punësim; si dhe Qasja.

Detajet e objektivave strategjike, aktivitetet e planifikuara të cilat do të kontribuojnë në arritjen e objektivave strategjike dhe rezultatet e pritshme janë si në vijim:

**Objektiva strategjike 1 në fushën e arsimit dhe zhvillimit profesional: Sigurimi i arsimit gjithëpërfshirës dhe fuqizimi i mekanizmave mbështetës për të ofruar shërbime cilësore për Personat me Aftësi të Kufizuara.**

Kjo objektivë strategjike ndërlihet drejtpërdrejt me promovimin e arsimit gjithëpërfshirës si dhe gjithëpërfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në institucionet arsimore, ngritjen e shërbimeve mbështetëse për fëmijët me aftësi të kufizuara, ofrimin e shërbimeve profesionale me bazë në komunitet, pajisjen e shkollave me pajisje ndihmëse dhe materiale didaktike, transportin e fëmijëve me aftësi të kufizuara, trajnimin dhe aftësimin e mësimitdhënësve për arsimin gjithëpërfshirës si dhe vlerësimin dhe sigurimin e qasjes fizike për të gjithë fëmijët me aftësi të kufizuara në institucionet arsimore në Komunën e Ferizajt.

Rezultatet e pritshme:

1. Deri në vitin 2023, në Komunën e Ferizajt 80% e fëmijëve me aftësi të kufizuara do të përfshihen në sistemin arsimor parauniversitar dhe do të kenë qasje në shërbimet mbështetëse.
2. Deri në vitin 2023 Komuna e Ferizajt do të siguroj shërbime mbështetëse për 40% të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe do siguroj që fëmijët me aftësi të kufizuara të kenë qasje në shërbimet profesionale me bazë në komunitet.
3. Deri në vitin 2023, 50% e institucioneve arsimore do të pajisen me mjetet ndihmëse dhe materialet e nevojshme didaktike për mësimitdhënie të fëmijëve me aftësi të kufizuara.
4. Deri në vitin 2023, 70% e mësimitdhënësve të Komunës së Ferizajt do të trajnohen për mësimitdhënie gjithëpërfshirëse.

***Aktivitetet e planifikuara***

Në vijim janë paraqitur aktivitetet e planifikuara për arritjen e rezultateve të pritshme:

- 1.1 Vlerësimi i gjendjes sa i përket qasjes fizike në të gjitha institucionet arsimore të Komunës së Ferizajt.
- 1.2 Regullimi i qasjes fizike në shkollat të cilat frekuentohen nga fëmijët me aftësi të kufizuara.
- 1.3 Rritja e shërbimeve mbështetëse (asistent) në institucionet arsimore sipas nevojave dhe kërkesave të fëmijëve me aftësi të kufizuara.
- 1.4 Sigurimi i paisjeve ndihmëse dhe materialeve didaktike për mësimitdhënës në institucionet arsimore.
- 1.5 Sigurimi i transportit për pjesëmarrje aktive të fëmijëve me aftësi të kufizuara në institucione arsimore.



1.6 Ofrimi i shërbimeve profesionale, psikologjike, logopedike me bazë në komunitet.

1.7 Trajnime profesionale për mësuesin për arsimin gjithëpërfshirës.

1.8 Promovimi i arsimit gjithëpërfshirës në Komunën e Ferizajt.

**Objektiva strategjike 2 në fushën e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale: Zgjerimi dhe përmirësimi i shërbimeve mjekësore, rehabilituese dhe sociale për personat me aftësi të kufizuara**

Kjo objektivë strategjike ndërlidhet drejtpërdrejt me ngritjen e vetëdijes së personelit shëndetësor të institucioneve shëndetësore publike dhe private sa i përket aftësisë së kufizuar, informimin e personave me aftësi të kufizuara lidhur me shërbimet e ofruara shëndetësore dhe sociale, përmirësimin e shërbimeve mjekësore, zgjerimin e shërbimeve psiko-sociale si dhe subvencionimin e trajtimeve në qendrat rehabilituese sipas nevojave të personave me aftësi të kufizuara.

Rezultatet e pritshme:

1. Deri në vitin 2023, në Komunën e Ferizajt 80% e personelit shëndetësor do të kenë njohuri për qasjen e personave me aftësi të kufizuara dhe institucionet shëndetësore do të kenë qasje për personat me aftësi të kufizuara.
2. Deri në vitin 2023, në Komunën e Ferizajt institucionet shëndetësore do të ofrojnë/kryejnë vizitat/shërbimet mjekësore në shtëpi për personat me aftësi të kufizuara të rënda.
3. Deri në vitin 2023, në Komunën e Ferizajt 50% e personave me aftësi të kufizuara do të kenë qasje në shërbimet sociale me bazë në komunitet.
4. Deri në vitin 2023, në Komunën e Ferizajt 20% e personave me aftësi të kufizuara do të subvencionohen për trajtim në qendrat rehabilituese.

***Aktivitetet e planifikuara***

Në vijim janë paraqitur aktivitetet e planifikuara për arritjen e rezultateve të pritshme:

- 2.1 Organizmi i aktiviteteve avokuese për ngritje të vetëdijes sa i përket aftësisë së kufizuar tek institucionet shëndetësore publike dhe private.
- 2.2 Vendorsja e tabelave informuese dhe posterëve të përshtatshëm për personat me aftësi të kufizuara brenda objekteve shëndetësore dhe sociale.
- 2.3 Sesione këshilluese dhe informuese me personel mjekësor (së paku një herë në vit), zyrtarë civil dhe familjarë në ofrimin e shërbimeve shëndetësore dhe sociale.

- 2.4 Diskutime publike për çështjet të cilat kanë të bëjnë me PAK në përmirësimin e shërbimeve të ofruara shëndetësore.
- 2.5 Organizimi i vizitave/shërbimeve mjekësore në shtëpi për rastet e rënda.
- 2.6 Subvencionim për trajtim në qendrat rehabilituese specifike sipas nevojave dhe aftësisë së kufizuar: banjat apo qendrat e fizioterapisë në spitale.
- 2.7 Shërbime sociale me bazë në komunitet për personat me aftësi të kufizuara.

**Objektiva strategjike 3 në fushën e aftësimin profesional dhe punësimit: Krijimi i kushteve dhe mundësive të barabarta për punësimin e personave me aftësi të kufizuara**

Kjo objektivë strategjike ndërlidhet drejtpërdrejt me zhvillimin e moduleve për aftësim profesional të personave me aftësi të kufizuara, aftësimin profesional të personave me aftësi të kufizuara përmes trajnimeve, kurseve dhe punës praktike dhe ngritjen e punësimit të personave me aftësi të kufizuara përmes aktiviteteve avokuese, granteve për vetëpunësim të personave me aftësi të kufizuara dhe bashkëfinancimit të ndërmarrjeve sociale.

Rezultatet e pritshme:

1. Deri në vitin 2023, në Komunën e Ferizajt do të vetëpunësohen 20 persona me aftësi të kufizuara të cilët do të përfitojnë nga grantet për vetëpunësim.
2. Deri në vitin 2023, në Komunën e Ferizajt 35 persona me aftësi të kufizuara do të kenë shkathësi të ngritura të punësimit përmes punës praktike.
3. Deri në vitin 2023, në Komunën e Ferizajt, gjegjësisht Qendra për Aftësim Profesional do ketë së paku 2 module të zhvilluara për aftësim profesional sipas aftësisë së kufizuar.
4. Deri në vitin 2023, në Komunën e Ferizajt së paku 50 persona me aftësi të kufizuara do zhvillojnë shkathësi të punësimit përmes pjesëmarrjes në trajnimet për aftësim profesional dhe kurseve tjera.
5. Deri në vitin 2023, në Komunën e Ferizajt do të punësohen 10 persona me aftësi të kufizuara në ndërmarrje sociale.
6. Deri në vitin 2023, në Komunën e Ferizajt 40% e bizneseve me mbi 50 punëtorë kanë të punësuar një person me aftësi të kufizuara.

***Aktivitetet e planifikuara***

Në vijim janë paraqitur aktivitetet e planifikuara për arritjen e rezultateve të pritshme:

- 3.1 Ndarja e granteve për vetëpunësim të personave me aftësi të kufizuara.

3.2 Ofrimi i punës praktike për personat me aftësi të kufizuara.

3.3 Bashkëfinancim i ndërmarrjeve sociale.

3.4 Zhvillim i moduleve për aftësim profesional sipas nevojave të personave me aftësi të kufizuara.

3.5 Trajnimi dhe aftësimi profesional i personave me aftësi të kufizuara në modulet e reja të krijuara nga QAP.

3.6 Organizimi i kurseve të ndryshme (matematikë, TIK, gjuhë të huaja, arte, artizanate, gatim, sporte, etj.) dhe aktiviteteve të tjera për personat me aftësi të kufizuara.

3.7 Aktivitete avokuese dhe sesione informuese për punësimin e personave me aftësi të kufizuara dhe mundësive për punësim dhe vetëpunësim.

3.8 Organizimi dhe menaxhimi i databazës për PAK (përmes punësimit të zyrtarit për menaxhimin e databazës për PAK).

**Objektiva strategjike 4 në fushën e qasjes: Avansimi dhe përmirësimi i qasjes në infrastrukturë ,transport, informim, kulturë, sport dhe shërbime tjera për të gjithë personat me aftësi të kufizuara**

Kjo objektive strategjike ndërlidhet drejtpërdrejt me plotësimin dhe ndryshimin e rregullores komunale për transportin publik, sigurimin e qasjes në shërbime për personat me aftësi të kufizuara, përmirësimin e infrastrukturës fizike për të ofruar qasje për të gjithë personat me aftësi të kufizuara në objektet publike dhe private, përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në aktivitetet kulturore, artistike dhe sportive, zbatimin e kriterëve për qasje gjatë procedurave të marrjes së lejeve për ndërtim, rregullimin e trotuareve dhe sinjalizimit në rrugë dhe udhërrëfyesit me shërbimet për personat me aftësi të kufizuara në Komunën e Ferizajt. Po ashtu kjo objektive do të ndërlidhet edhe me çështjen e ndërgjegjësimit të personave me aftësi të kufizuara mbi të drjetën e trashëgimisë.

1. Deri në vitin 2023, rregullorja komunale për transport publik të udhëtarëve do të plotësohet dhe ndryshohet, dhe do të sigurohet qasje në transport publik për personat me aftësi të kufizuara.
2. Deri në vitin 2023, në Komunën e Ferizajt 30% e trotuarave të vjetra dhe të gjitha trotualet e reja do të kenë qasje për personat me aftësi të kufizuara.

3. Deri në vitin 2023, në Komunën e Ferizajt 20% e sinjalizimit në rrugë do të jetë sipas standardeve për qasje të personave me aftësi të kufizuara.
4. Deri në vitin 2023, në Komunën e Ferizajt 20% e objekteve publike dhe private do të kenë qasje për personat me aftësi të kufizuara.
5. Deri në vitin 2023, personat me aftësi të kufizuara në Komunën e Ferizajt do të qasje në fonde për zhvillimin e aktiviteteve kulturore dhe artistike.
6. Deri në vitin 2023, së paku 20% e të rinjëve me aftësi të kufizuara në Komunën e Ferizajt do të marrin pjesë aktive në aktivitete sportive
7. Deri në vitin 2021, në Komunën e Ferizajt 15% e personave me aftësi të kufizuara do të kërkojnë të drejtën e tyre trashëgimore

### ***Aktivitetet e planifikuara***

Në vijim janë paraqitur aktivitetet e planifikuara për arritjen e rezultateve të pritshme:

- 4.1 Plotësimi dhe ndryshimi i rregullores komunale për transportin publik të udhëtareve për të siguruar qasje për personat me aftësi të kufizuara.
- 4.2 Rregullimi trotuareve të reja dhe përmirësimi i trotuareve ekzistuese në Komunën e Ferizajt sipas standardeve për qasjen e personave me aftësi të kufizuara.
- 4.3 Sinjalizimi në rrugë dhe objekte sipas standardeve për personat me aftësi të kufizuara.
- 4.4 Përfshirja e kriterëve për qasje në objekte/hapësira publike dhe private për marrjen e lejes së ndërtimit.
- 4.5 Përmirësimi dhe modifikimi i infrastrukturës fizike për qasje në hapësira/objekte publike dhe private.
- 4.6 Sigurimi i qasjes në shërbime për personat me aftësi të kufizuara përmes alfabetit Braille dhe interpretit të gjuhës së shenjave.
- 4.7 Hartimi dhe shtypja e udhërrëfyesit të shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara.
- 4.8 Mbështetja financiare e aktiviteteve kulturore dhe artistike për Personat me Aftësi të Kufizuara
- 4.9 Përfshirja e të rinjve nga radhët e PAK në aktivitetet sportive rinore
- 4.10 Inkurajimi i zhvillimit të sportit për PAK përmes financimit të trajnerëve sportiv

#### 4.11 Ndërgjegjësimi i PAK dhe komunitetit për të drejtën trashëgimore të PAK

##### **Buxheti**

Përlllogaritjet e buxhetit për zbatimin e strategjisë komunale për personat me aftësi të kufizuara janë bërë me qëllim të përcaktimit të kornizës financiare dhe fondeve të nevojshme për zbatimin e strategjisë komunale në periudhën 5 vjeçare si dhe me qëllim të identifikimit të nevojave financiare të cilat mund të mbulohen nga donatorët potencial.

Objektiva strategjike 1: Arsimit dhe ngritje profesionale e mesimdhensesve

**Sigurimi i arsimit gjithepershires dhe fuqizimi i mekanizmeve mbeshtetes per te ofruar sherbime cilësore per Personat me aftësi të kufizuar.**

Aktiviteti	Treguesi	Mjetet e verifikimit	2019	2020	2021	2021	2022	Institucioni zbatues	Institucion i mbështetës	Buxheti
1.1. Vlerësimi i qasjes fizike në të gjitha institucionet arsimore të Komunës së Ferizajt.	Analiza e gjendjes Raporti me të dhënat nga terreni	Raporti me gjendjen ekzistuese	X					Drejtoria e Infrastrukturës Drejtoria e Arsimit	Handikos	500€
1.2. Rritja e shërbimeve mbështetëse (asistent) në institucionet arsimore sipas nevojave dhe kërkesave të PAK.	Analiza e gjendjes së institucioneve ku ka nevojë për asistent	Numri i asistentëve të punësuar në institucione arsimore.	X					Drejtoria e Arsimit	Drejtoria e Administratës së Përgjithshme	Pagat (Sqarim: Pagat bazë të koeficientit për mesimdhënësit mbështetës)
1.3. Sigurimi i paisjeve ndihmëse dhe materialeve didaktike për mesimdhënësit në institucionet arsimore.	40 % e institucioneve arsimore janë të pajisura me mjete ndihmëse dhe	Raporti i mjeteve të pranuar në institucionet arsimore.	X	X	X	X	X	Drejtoria Komonale e Arsimit	Drejtoria e Financave Donatorë	100 000 (rreth 20,000€ në vit)



		ndërgjegjsues.									
		Numri i materialeve të shpërndara.									

Objektiva strategjike 2: Shëndetësi dhe mirëqenie sociale

**Zgjerimi dhe përmirësimi i shërbimeve mjekësore, rehabilituese dhe sociale për Personat me Afësi të Kufizuar**

Aktiviteti	Treguesi	Mjetet e verifikimit	2019	2020	2021	2021	2022	Institucioni zbatues	Institucion i mbështetës	Buxheti
2.1 Organizmi i aktiviteteve avokuese për ngrijë të vetëdijes sa i përket afësisë së kufizuar tek institucionet shëndetësore publike dhe private.	Numri i takimeve, sesioneve këshilluese me përfaqësues të institucioneve shëndetësore dhe sociale.	Materialet promovuese, Raportet e aktiviteteve, Listat e pjesëmarrjes.	X	X	X	X	X	Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale OPAK	QKMF QMF-të Donatorë	5.000€ (rreth 1.000€ në vit).
2.2 Vendosja e tabelave informuese dhe posterëve të përshatshëm për personat me	institucionet publike janë të pajisura me tabela informuese të	Numri i institucioneve që kanë	X					Drejtoria e Shëndetësisë dhe	QKMF QMF-të	10.000€



	përshatshme për personat me aftësi të kufizuara në të parë dhe dëgjim, Institucionet publike kanë posterë informues me të dhëna shitesë edhe për PAK.	vendosur tabelat.								Mirëqenies Sociale.	OPAK	
afhtësi të kufizuara brenda objekteve shëndetësore dhe sociale.												
2.3 Sesiione këshilluese dhe informuese me personel mjekësor (së paku një herë në vit) zyrtarë civil dhe familjarë në ofrimin e shërbimeve shëndetësore dhe sociale.	Numri i seancave këshilluese dhe informuese.	Listat e pjesëmarrësve, Agjenda, Raportet.	X	X	X	X	X	X	X	Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale	OJQ-të	1,500€ (500€ në vit).
2.4 Diskutime publike për çështjet të cilat kanë të bëjnë me PAK në përmisimin e shërbimeve të ofruara shëndetësore	Numri i sesiioneve Numri i pjesëmarrësve	Listat e pjesëmarrësve Agjendat Raportet Fotografië	x	x	X					Drejtoria e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale Komuna OPAK	Mediat OJQ-të Kuvendi komunal	Pa kosto
2.5 Organizimi i vizitave/shërbimeve mjekësore në shtëpi për	Numri i personave me aftësi të kufizuara që marrin	Formularët e vizitave dhe listat e	x	X	X	x	x	x	x	QKMF	OPAK OJQ-Të	5,000 (rreth 1,000€

Objektiva strategjike 3: Afësim profesional dhe punësim

**Krijimi i kushteve dhe mundësive të barabarta për punësimin e Përsonave me Afësi të Kufizuara**

Aktiviteti	Treguesi	Mjetet e verifikimit	2019	2020	2021	2022	2023	Institucioni zbatues	Institucioni m'ështëetës	Buxheti
3.1 Ndërtimi i qendrave të punësimit për të aftësitë me afësi të kufizuara dhe sipas nevojave të afësisë së kufizuar: banjat apo qendrat e fizioterapisë në spitale.	20 persona me afësi të kufizuara të yetë të punësimit të kufizuar që trajtohen në qendra të shërbimeve të shëndetësive të punësimit të kufizuar.	Numri i vizitave dhe vizitave të izohesive të listat e punësimit të kufizuar në përfituesve të punësimit të kufizuar.	X	X	X	X	X	Drejtoria e Shëndetësisë dhe Zhvillimit Ekonomik Mirëqenies Sociale	Donatorët biznesit, donatorët	50,000€ (rreth 2,000€ në vit) (Së pakti 10,000 në vit ndahen)
2.6 Shërbime psiko-sociale me bazë në komunitet për personat me afësi të kufizuara.	Numri i personave me afësi të kufizuara që marrin shërbime, Llojet e shërbimeve	Formularët e vizitave, Raportet	X	X	X	X	X	Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale	Donatorë OJQ-të	50,000€ (rreth 12,000 në vit)

	dara për etëpunësimin e personave me aftësi të kufizuara	zineseve Numri i personave me aftësi të kufizuara të punësuar	X	X	X	X	X	për grantet e vetëpunësimit të PAK)
3.2 Ofrimi i punës praktike për personat me aftësi të kufizuara	Numri i PAK që ka kryer punë praktike në institucione lokale.	Vërtetim për përfundim të praktikës nga Drejtoria e Administratës	X	X	X	Komuna e Ferizajt dhe ndërmarrjet publike.	OJQ-të	Nuk ka kosto
3.3 Bashkëfinancim i ndërmarrjeve sociale	Një ndërmarrje sociale është hapur 10 persona me aftësi të kufizuara janë të punësuar	Regjistrimi i ndërmarrjes në qendrën e regjistrimit të bizneseve	X	X	X	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik	Komuna, OP,AK Donatorë	50,000€ (25,000€ investim për dy vite me radhë)
3.4 Zhvillim i moduleve për aftësim profesional sipas nevojave të personave me aftësi të kufizuara.	Moduli për aftësim profesional sipas nevojave të personave me aftësi të kufizuara është zhvilluar. Angazhimi i ekspertit për zhvillim të	Agjendat e 4 seanceve konsultative dhe nevojat e identifikuar Agjendat e 2 punëtorive të mbajtura	X			Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik Qendra e Aftësimit Profesional	OPAK Donatorët	5,000€ (200€ per seanca konsultative, transport ushqimi për pjesëmarrës, 850€ #2 punëtori për

3.5 Trajnimi dhe aftësimi profesional i personave me aftësi të kufizuara në modulet e reja të krijuara nga QAP.	moduleve.	<p>Listat e pjesëmarrjes (sesione dhe punëtori)</p> <p>Moduli i zhvilluar</p> <p>Kontrata e ekspertit</p>						X	X	X	Qendra për Aftësim Profesional	Komuna Donatorët	ushqim, piqe, 2,500€ per ekspertin)
3.6 Organizimi i kurseve të ndryshme (matematikë, TIK, gjuhë të huaja, arte, artizanate, gatim, sporte, etj)	50 persona me aftësi të kufizuara kanë vijuar kurset dhe	<p>Foto</p> <p>Lista e pjesëmarrjes</p> <p>Trajnimet e mbajtura</p> <p>Kontrata e trajnereve</p>	X	X	X	X	X	X	X	X	Qendra për Aftësim Profesional	Komuna Donatorë	5,550€ (1250€ *3 vite, shpenzime për piqe, ushqim, sallë. Shpenzimet për trajner për vit (150€ x 4 ditë 600 euro)total për 3 vite 1800
		Lista e pjesëmarrjes	X	X	X	X	X	X	X	X	Qendra për Aftësim Profesional	Komuna Donatorë	5,000€ (rreth 1,00 në



4.1 Plotësimi dhe ndryshimi i rregullores komunale për transportin publik të udhëtarëve për të siguruar qasje për Personat me Afësi të Kufizuara (së paku 2 takime pune/ punetori për plotësimin e rregullores).	Rregullorja e plotësuar dhe ndryshuar	Aprovimi i rregullores në Kuvend Komunal	X	X	X	X	X	X	Drejtoria për shërbime publike Zyra ligjore	Drejtorië tjera Komunale Asambleja Komunale e Ferizajt	200€ (për shpenzimet e grupeve punuese për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores)
4.2 Rregullimi trotuareve të reja dhe përmirësimi i trotuareve ekzistuese në Komunën e Ferizajt sipas standardeve për qasjen e Personave me Afësi të Kufizuara (pjerrina, largimi i pengesave, fusha taktile, renovimi i pjesëve të dëmtuara etj.)	Trotuarët me qasje për personat me aftësi të kufizuara  Analiza e qasjes së trotuareve në Komunën e Ferizajt	Rezultatet e analizës	X	X	X	X	X	X	Drejtoria për Shërbime Publike  Drejtoria e infrastrukturës	Komiteti për në të Komunës Handikos dhe OPAK të tjera lokale  Donatorët	450.000€  (20.000€ në vit për përmirësimin e trotuareve të vjetra dhe 70.000€ në vit për trotuare të reja)
4.3 Sinjalizimi në rrugë dhe objekte sipas standardeve për Personat me Afësi të Kufizuara (semaforët me zë, fushat taktile, etj)	Sinjalistika sipas standardeve për Personat me Afësi të Kufizuara  Analizë e	Rezultatet e analizës	X	X	X	X	X	X	Drejtoria për shërbime publike	Drejtoria e infrastrukturës OPAK (për analizë)	100.000€ (20.000€ në vit për rregullimin e sinjalistikës)

	sinjalistikës rugore									Donatorët	
4.4 Përfshirja e kriterëve për qasje në objekte/hapësira publike dhe private për marrjen e lejes së ndërtimit.	Zbatimi i vendimit	Vendimi i Kryetarit të Komunës për zbatimin e kriterit të qasjes për PAK në dhënieve të lejeve të ndërtimit.	X	X	X	X	X	X	X	Inspektoriat komunal	0€
4.5 Përmirësimi dhe modifikimi i infrastrukturës fizike për qasje në hapësira/objekte publike dhe private.	Analizë e gjendjes aktuale që kanë nevojë për përmirësim dhe modifikim  Infrastrukturë sipas standardeve për PAK	Raporti i analizës  Raportet nga inspektimi	X	X	X	X	X	X	X	OPAK lokal  Donatorët	100.000€  (20-30,000 euro në vit)
4.6 Sigurimi i qasjes në shërbime për PAK përmes alfabetit Braille dhe interpretit të gjuhës së shenjave.	Broshura në gjuhën e Brail-it në hyrje të komunës me informata për departamentet e Komunës.  Së paku 2 interpretë të gjuhës së shenjave	Broshurat e publikuara në gjuhën e Brail-it  Angazhimi i interpretëve (lista e të punësuarëve në Drejtorinë e	X	X	X	X	X	X	X	Komuna e Ferizajt	40.000€  (2.000€ për Broshura dhe 9,600€ në vit për interpretin)

	në kuadër të Komunës	Administratës së Përgjithshme)										
4.7 Hartimi dhe shtypja e udhërrëfyesit të shërbimeve për Personat me Afësi të Kufizuara.	Krijimi i grupit punues Mbajtja e takimeve/punëtorive për draftim Mbledhja e fotove/informatave në teren	Udhërrëfyesi i hartuar dhe shtypur	X	X	X	X	X	X	X	Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale	Zyra e Kryetarit të Komunës, Drejtoritë Komunale, OPAK	5,000€ (takime, grumbullim i informatave, dizajnim, publikim, shtypje)
4.8 Mbështetja financiare e aktiviteteve kulturore dhe artistike për Personat me Afësi të Kufizuara	Se paku një aktivitet i financuar nga DKRS i cili përkrahë aktivitetet kulturore dhe artistike të PAK	Numri i aktiviteteve të financuara nga DKRS për PAK	X	X	X	X	X	X	X	Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit	Zyra e Kryetarit të Komunës, Drejtoritë Komunale, OPAK	15,000€ (3,000€ në vit për aktivitete kulturore dhe artistike)
4.9 Përfshirja e të rinjve nga radhët e PAK në aktivitetet sportive rinore	Së paku 10% të rinjve me aftësi të kufizuara të përfshirë në aktivitetet sportive, mini olimpiada, kampe verore etj	Numri i të rinjve (PAK) në aktivitetet si kampe verore, mini olimpiadat etj	X	X	X	X	X	X	X	Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit	Zyra e Kryetarit të Komunës, Drejtoritë Komunale, OPAK	15,000€ (3,000€ në vit për aktivitete sportive)
4.10 Inkurajimi i zhvillimit të sportit për PAK përmes financimit të trajnerëve sportiv	Së paku 1 trajner i angazhuar për trajnime sportive	Numri i të rinjve të		X	X	X	X	X	X	Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe	Zyra e Kryetarit të Komunës,	15,000€ (5,000€ në vit



	Së paku 10% e të rinjëve me aftësi të kufizuara marrin pjesë në trajnimet sportive	trajnuar					Sportit	Drejtoritë Komunale, OPAK	për trajner të aktiviteteve sportive
4.11 Ndërgjegjësimi i PAK dhe komunitetit për të drejtën trashëgimore të PAK	Së paku një aktivitet avokues për të drejtën trashëgimore të PAK Së paku 2 punëtori/konferenca për të drejtën trashëgimore	Numri i trajnerëve të angazhuar Numri i punëtorive të mbajtura Numri i aktiviteteve avokuese	X	X			OPAK	OPAK	5000€ (për punëtori, dhe aktivitete avokuese)

**Strategjia 01 Nr. 115**

**Data: 27.12.2018**

**Ferizaj**

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunitetit**

  
**Kristina Gashi Bytyçi**